

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Përzgjedhur Produkti i Vtit - Shqipëri” Sh.p.k.

Në këtë statut:

- Ligj është Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar;
- “Statut” eshte Statuti i Shoqerise;

KREU I

Themelimi, Emërtimi, Objekti, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1 – Themelimi, Forma dhe Ortaket

- 1.1. Sot më datë 29.05./2019, ne, themeluesit vendosëm krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me emrin “Përzgjedhur Produkti i Vtit - Shqipëri” Sh.p.k., veprimtaria e së cilës do të rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2. Themeluesit e shoqërisë janë:
Znj. Ilda Mara, adresa rruga Marko Boçari, Pallati TID 2, Ap. 29
Tirane 1001, Shqipëri
Z. Hazis Vardar, adresa 42 Rue de Clichy, 75009 Paris, France
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i Shoqërisë është “Përzgjedhur Produkti i Vtit - Shqipëri” Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1 Shoqëria ka si objekt veprimtarie të gjitha aktivitetet që lidhen me zhvillimin e eveneve, panaireve, workshop koncerteve, promocioneve dhe konkurseve. Zhvillimin e eveneve, konkurseve për përzgjedhjen e produkteve me të mira. në baza vjetore, të mallrave të konsumit, të shërbimeve, industrive etj.
- 3.2 Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, import-eksport, të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh. Të kontraktejo marrjen e licencave nga markat e huaja, të ketë interesa, ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për

arrijen e qëllimeve të shoqërisë.

- 3.3 Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjeter të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Nikolla Jorga, Pallati Delta 2, Tirane 1001
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjeter bëhet me vendimin e Asambleje së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përsaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë per një afat kohe të pacaktuar.
- 5.2. Shoqëria mund të prishet në cdo moment që mund të vendoset prej ortakëve

KREU II

Kapitali themeltar, Kontributet, Ndarja e pjesëve të kapitalit

Neni 6 – Kapitali themeltar dhe Kontributet

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, ku secili zoteron nga 1 kuotë.
Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përpunjje me kontributet e tyre si më poshtë:
1. Ortaku Themelues Znj. Ilda Mara, i kuotë, me vlerë të përgjithshme 51 000 Lekë që përbën 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë,. Kontributi i ortakut është paguar në të holla.
 2. Ortaku Themelues Z. Hazis Vardar i përkasin i kuotë, me vlerë të përgjithshme 49 000 leke që përbën 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakut është paguar në të holla.

Neni 7 - Rritja e kapitalit themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, me vendim të Asamblesë së Ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.
- 7.2 Në rast rritjeje të kapitalit, kuotat e ortakeve të Shoqerise do të rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblese.
- 7.3 Nëasnje rast shumica nuk mund të detyroje një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar.

Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve, me votën pro të ortakëve që zoterojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë.

Neni 9 – Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 9.1 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, sipas nenit 73 te ligjit 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.
- 9.2 Në rast transferimi të pjesëve të kapitalit në çdo lloj forme në favor të personave të tjera nga ata të parashikuar më sipër, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin, ortakët e tjera gjëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto pjesë kapitali.
- 9.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë pjesët e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjera, me letër rekomande, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të kapitalit ofruar për shitje.
- 9.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesët e kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e

tyre e parablerjes.

- 9.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, pjesët e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon pjesët e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë më pjesët që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 9.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblesë që përfaqëson të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katrat) e kapitalit themeltar.
- 9.7 Në rast të transferimit të pjesëve të kapitalit për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Nese ortaket e Shoqerise nuk jepin perlqimin e tyre per ortket e rinj pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblesë që përfaqëson të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katrat) e kapitalit themeltar.

KREU III

Organet vendimmarrëse dhe Drejtuese

Neni 10 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 10.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim në statut sipas modalitetave të përcaktuara nga ligji.
- 10.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjës për martjen e vendimime për shoqérinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 10.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nëpërmjet një autorizimi, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 10.5 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me letër rekomande ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 11.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve ose nga një ose disa ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 5% (pese per qind) te kapitalit themeltar.
- 11.4 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, si dhe jashtë territorit Shqipëtarë.
- 11.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'i lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 11.6 Asambleja vendos mbi ndryshimet në Statut me votën *pro* të ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.
- 11.7 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë përson tjetër i caktuar nga e njëjta Asamble. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që

mund të jetë edhe jo-ortak.

- 11.8 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formalitetave të njoftimit të parashikuara në pikën 1 të këtij nenit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.

Neni 12

Kuorumi

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 12.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 12.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 13

Marrja e vendimeve

- 13.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 13.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

- 13.3 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 14

Përjashtimi nga e drejta e votes

- 14.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënen ose jo të përsitimeve të reja.
- 14.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 15

Administrimi

- 15.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 15.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të ligjit, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 15.3 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorëve, bashkarisht apo veçmas.
- 15.4 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- 15.5 Znj. Ilda Mara emërohet administrator i shoqërisë për një afat 5 (pese) vjeçar.

Të dhënat e identifikimit:

Ilda Mara

rruga Marko Boçari, Pallati TID 2, Ap. 29 Tirane 1001 dhe nënshkrimit:
(mbiemrat, emrat, adresat):

Neni 16

Kompetencat e Administratorëve

16.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullit të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

16.2 Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- a) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 16.3 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 17

Përgjegjësitë e Administratorit

- 17.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajtë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 17.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 17.3 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.

KREU IV

Viti finansiar-Ekspertet

Neni 18

Viti Financiar

- 18.1 Viti finansiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtmisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë ne Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 19 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 19.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar.
- 19.2 Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 19.3 Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergaat reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.
- 19.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 20 – Fitimet

- 20.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) e kapitalit themeltar, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 20.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KREU V


Prishja, Likuidimi dhe Riorganizimi i shoqërisë

Neni 21 – Prishja

- 21.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, e ndryshuar;
 - d) me vendim të gjykatës;
- 21.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 22 – Likuidimi

- 22.1 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 22.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 22.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin finanziar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi



përfundimin e procesit të likuidimit.

- 22.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.
- 22.5 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 23

Riorganizim i shoqërisë, Bashkimi-Ndarja

- 23.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 24 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 24.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 24.2 Në rast se nuk arrihet një marreveshje atehere palet do ti drejtohen Gjykates

Neni 25


Baza Ligjore

- 25.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plete me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- 25.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 26

Mosmarrëveshjet


- 26.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.




* * *

O R T A K E T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
*** EMERTIMI I SHOQËRISE***
“ Përzgjedhur Produkti i Vtitit - Shqipëri ” Sh.p.k.

Ilda Mara



Hazis Vardar



**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ Përzgjedhur Produkti i Vtit - Shqipëri ” Sh.p.k.**

Sot më datë 29.05.2019 __, ne, themeluesit Znj. Ilda Mara, adresa rruga Marko Boçari, Pallati TID 2, Ap. 29 Tirane 1001 dhe Z. Hazis Vardar, adresa 42 Rue de Clichy, 75009 Paris, France, vendosëm krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me emrin “ Përzgjedhur Produkti i Vtit - Shqipëri ” Sh.p.k., si dhe nënshkrimin e Aktit të Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë “Shoqëria”), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e tij.

Neni 1 – Emërtimi

1.1 Emërtimi i Shoqërisë është “ Përzgjedhur Produkti i Vtit - Shqipëri ” Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Nikolla Jorga, Pallati Delta 2, Tiranë 1001

Neni 3 - Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

4.1 Shoqëria ka si objekt veprimtarie të gjitha aktivitetet që lidhen me zhvillimin e evenete, panaire, workshop, koncerete, promocion dhe konkurse. Zhvillimin e eventeve, konkurseve për përzgjedhjen e produkteve me të mira, në baza vjetore, të mallrave të konsumit, të shërbimeve, industrive etj.

4.2 Shoqëria mund të kryeje çdo aktivitet tjeter të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë per një afat kohe të pacaktuar.

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, ku secili zotëron nga 1 kuotë.

Neni 7 – Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
 - Znj. Ilida Mara, i përket 1 kuotë, me vlerë të përgjithshme 51 000 Lekë që përbën 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakut është paguar në të holla.
 - Z. Hazis Vardar i përket 1 kuotë, me vlerë të përgjithshme 49 000 leke që përbën 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakut është paguar në të holla.

Neni 8 – Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 8.1 Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 9 – Administratorët

- 9.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:
 - Znj. Ilida Mara e cila emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar.
- 9.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Statutit të shoqërisë.
- 9.3 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjera.

* * *



2



ORTAKET E SHOQERISE

Hazis VARDI

~~Ortaket e Shoqerise~~

Ildi Mere

~~Ildi Mere~~